



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06/IA009

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 30 gusht 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

**Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit:**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Kadri Veselit:**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit:**

Dejvid Jang

**Mbrojtësit të viktimave:**

Sajmon Loz

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:**

Venkatesvari Alagenda

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke marrë parasysht nenet 33(1)(c), dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullat 97(1)(a), (3), 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelet e z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi, z. Jakup Krasniqi (“të akuzuarit”) dhe të Prokurorit të Specializuar kundër vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake në lidhje me juridiksionin e Dhomave të Specializuara (“apelet”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin mbi mocionet paraprake të të akuzuarve me të cilët ngritën kundërshtime lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara s.<sup>2</sup>

2. Më 27 gusht 2021, të akuzuarit dhe Prokurori i Specializuar dorëzuan apele kundër Vendimit të Kundërshtuar.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup>IA009/F00012, Apel i Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 27 gusht 2021; IA009/F00010, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 27 gusht 2021; IA009/F00011, Apeli i Mbrojtjes së Selimit kundër “Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”, 27 gusht 2021; IA009/F00013, Apel i Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara me Shtojcën Publike 1, 27 gusht 2021; IA009/F00014, Apeli i Prokurorisë kundër “Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara” në pajtim me rregullën 97(3) me Shtojcën Publike 1, 27 gusht 2021. *Shih gjithashtu* F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 22 korrik 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

<sup>2</sup> Shih në përgjithësi Vendimin e Kundërshtuar.

<sup>3</sup> Shih në përgjithësi apelet.

## II. CAKTIMI

3. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

### **KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Emilio Gati**

**Gjykatësen Nina Jorgensen**

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me apelet.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E hënë, 30 gusht 2021  
Hagë,  
Holandë